



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Rron 2019" të datës 21.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 16.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Rron 2019" e datës 21.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 16.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Rron 2019" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Rron 2019" (tutje "parashtruesi") me datë 21.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 16.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet kryesore të parashtruesit janë se OE që i është dhënë kontrata dhe kemi gjetur se OE DHF Company nuk i ka dorëzuar kontratat për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë jo më pak se 400.000,00 euro.

Fillimisht duhet cekur se ky pretendim ka të bëj me kërkesën vijuese të dosjes së tenderit:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional 1.Operatori duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontrata për furnizime të ngjashme (lende djegese) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të këtij Njoftimi për Kontratë jo me pak se 400.000,00.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e furnizimeve.
---	-----------	---	--

Nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar si provë në këtë rast është gjetur se i njëjti ka dorëzuar dëshminë e kërkuar dokumentare "listën e kontratave të realizuara duke plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit...(në 3 vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë jo më pak se 400,000.00 euro)". Përndryshe nga formulimi i pretendimit mund të konfirmohet se as vet parashtruesi nuk e konteston që tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar listën e kontratave. Sidoqoftë Autoriteti Kontraktues në përputhje edhe me vendimin e OSHP 733/23 ka dërguar një letër standarde për sqarime shtesë për tenderuesin e rekomanduar i cili është përgjigjur në këtë kërkesë duke dërguar edhe dokumentet shtesë të kërkuara si dëshmi pikërisht për listën e kontratave sipas kërkesës përkatëse të dosjes së tenderit. Në këtë mënyrë sipas vendimit të OSHP është kryer rivlerësimi në përputhje me LPP dhe RRPP si dhe janë kërkuar sqarimet shtesë të nevojshme. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Sidoqoftë, nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij dhe nuk ka paraqitur fare argumente ose prova për të mbështetur kërkesën e tij për rishqyrtim. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 24.11.2023

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net